



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:050314

Datë: 02.05.2024

Numri i dokumentit: 05646660

KPPP.nr. 903/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përbarimore të kreditorit Komuna e Gjakovës, kundër debitorit “Sigma Group” L.L.C., me numër të regjistrimit të biznesit 810809626 dhe seli në Gjakovë, duke vepruar sipas propozimit të debitorit ushtruar ndaj Urdhrit Përbarimor P.nr. 267/23, i lejuar me datë 15.05.2023, nga Përbaruesi Privat Gëzim Gjoshi, me seli në Gjakovë, jashtë seancës, me datë 02.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË si i pa afatshëm propësimi i debitorit “Sigma Group” L.L.C., me numër të regjistrimit të biznesit 810809626 dhe seli në Gjakovë, i ushtruar ndaj Urdhrit Përbarimor P.nr. 267/23, i lejuar me datë 15.05.2023, nga Përbaruesi Privat Gëzim Gjoshi.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën e dokumenteve të besueshme, Faturës nr. 482/22, e datës 12.01.2022; Faturës nr. 7927/22, e datës 31.01.2022; Faturës nr. 32626/22, e datës 28.04.2022; Faturës nr. 41917/22, e datës 24.05.2022; Faturës nr. 60135/22, e datës 27.07.2022 dhe Faturës nr. 81661/22, e datës 28.10.2022, ka lejuar Urdhrin Përbarimor P.nr. 267/23, të datës 15.05.2023, me të cilin është urdhëruar debitori që brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të urdhrin, t’ia paguajë kreditorit shumën prej EUR 14,086.80, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data kur kërkesa është bërë e arritshme e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore.

Kundër këtij urdhri, debitori me datë 30.05.2023, ka paraqitur propësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përbarimor me arsyetimin se Përbaruesi Privat ka lejuar përbarimin

në bazë të faturave të lëshuara nga kreditori për kontratën e qirasë, ku në raporte kontraktuese të qiradhënies vetëm dokumentet noteriale sipas LPP-së mund të jenë të përbarueshme. Më tej, ka theksuar se në kontratën e qirasë në mes të kreditorit dhe debitorit nuk është paraparë që kreditori të lëshoj faturë për qira mujore, ashtu që mënyra e pagesës është paraparë që të bëhet përmes deponimit në xhirollogari, siç është përcaktuar me nenin 5 të kësaj kontrate. Duke qenë se dokumenti në bazë të së cilit është lejuar urdhri përbarimor nuk është i përshtatshëm për përbarim, i ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përbarimor të anulohet.

Kreditori, përmes përfaqësuesit të autorizuar ka paraqitur përgjigjen në prapësim me të cilin e ka kundërshtuar prapësimin e debitorit me arsyetimin se i njëjti është i pasafatshëm dhe se nuk përmban asnjë provë me të cilën do t'i mbështeste pretendimet e tij të paraqitura në prapësim. Ka shtuar se debitori ka pranuar faturat, e për të cilat ekzistojnë fletë kthesat, si dhe të njëjtat nuk i ka kundërshtuar. Për këto arsye, i ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit si të pa themeltë.

Gjykata, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se prapësimi i debitorit është i pasafatshëm, për arsyet si në vijim:

Nga shkresat e lëndës rezulton se debitori me datë 22.05.2023 e ka pranuar Urdhrin Përbarimor P.nr. 267/23, të datës 15.05.2023, nga Përbaruesi Privat Gëzim Gjoshi, fakt ky i cili vërtetohet nga fletë-kthesa për dorëzim personal të përbaruesit privat e cila gjendet në shkresat e lëndës. Ndërsa, nga shkresat e lëndës, rezulton se debitori me datë 30.05.2023 ka paraqitur prapësimin ndaj këtij urdhri.

Sipas dispozitës së nenit 70 të Ligjit për procedurën përbarimore përcaktohet se *“Prapësimi duhet t'i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përbarues ose urdhrin përbarues”*, ndërsa me nenin 126, paragrafi 2 të Ligjit për procedurën kontestimore, përcaktohet se *“Në qofte se afati është caktuar me ditë, përjashtohet nga llogaritja dita në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të filloj afati, kështu që për fillim të afatit merret dita e parë e ardhshme.”*

Në mbështetje të dispozitave si më lartë, si dhe nisur nga fakti se debitori urdhrin përbarimor e ka pranuar me datë 22.05.2023, ndërsa afati për paraqitjen e prapësimit ka filluar të rrjedhë nga data 23.05.2023, rezulton se dita e fundit për paraqitjen e prapësimit ka qenë data 29.05.2023.

Prandaj, meqë debitori prapësimin e ka paraqitur me datën 30.05.2023, ndërsa në shkresa të lëndës nuk ka prova që prapësimi është dorëzuar në ndonjërin nga mënyrat e tjera të përcaktuara për dërgimin e shkrësive, rezulton se debitori prapësimin e ka paraqitur pas kalimit të afatit ligjor, dhe rrjedhimisht prapësimi i debitorit është i pa afatëshëm.

Nga sa më sipër, gjykata në mbështetje të nenit 73, paragrafi 3 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 903/23, datë 02.05.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.